AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Anketa e Mbeturinave Komunale (AMK), 2022

17.11.2023

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon rezultatet e Anketës së Mbeturinave Komunale (AMK) për vitin 2022.

Rritje e lehtë e sasisë së mbeturinave komunale në 2022

Rezultatet e prezantuara në këtë publikim ofrojnë një burim të rëndësishëm statistikor për gjendjen e tanishme të këtij sektori.

Të dhënat e AMK 2022, tregojnë se gjithsej sasia e mbeturinave komunale të grumbulluara në vitin 2022 ishte 488 mijë ton/vit, ku krahasuar me të dhënat e vitit 2021, ka një rritje prej 0,6%.

Mbeturinat Komunale të grumbulluara në vitin 2022

Vendi i grumbullimit	Sasia e grumbulluar	Popullsia[1]	Mbeturina të grumbulluara	
Njësia	1000/ton		kg/banorë/vit	kg/banorë/ditë
Prishtina dhe Rajoni[2]	146	497 431	297	0,81
Rajonet tjera	342	1 300 757	267	0,73
Gjithsej Kosova	488	1 798 188	275	0,75

Të dhënat e vitit 2022 tregojnë se mesatarja e mbeturinave komunale të grumbulluara në Kosovë ishte 275 kg/ banorë/vit. Ndërsa, mesatarja e mbeturinave të grumbulluara për banorë në ditë ishte 0.75 kg.

Mbeturinat komunale të grumbulluara sipas rajoneve në vitin 2022

Sasia më e madhe e mbeturinave komunale të grumbulluara në vitin 2022 ishte në rajonin e Prishtinës, me 146 mijë t/vit, ose 30,0 %, ndërsa sasi më e vogël e mbeturinave komunale të grumbulluara vërehet në rajonin e Ferizajt me 37 mijë t/vit, ose 7,7%.

Në Prishtinë dhe rajonin e saj, mesatarja e mbeturinave komunale të grumbulluara për banorë në ditë ka qenë 0.81 kg. Në rajonet e tjera të Kosovës, mesatarja e mbeturinave komunale të grumbulluara për banorë në ditë ishte 0.73 kg.

AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Mbeturinat komunale sipas rajoneve, 2022 (%)



Për më shumë informata lidhur me rezultatet e Anketës së Mbeturinave Komunale (AMK) për vitin 2022, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/Environment